REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 870/20
Datë/Datum. 24.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH .nr. 870/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068,dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. Blerim Dina - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: OE "Albi Company"shpk- Rahovec, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: N.T. "PLEQJA"-Deçan, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Punët përfundimtare – Restaurimi Konservimi i Kullës Fazli Boqollit, Raushiç-Pejë", me numër të prokurimit: 207-20-2516-5-2-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – "Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve"/MKRS/, më datën: 23.11.2020, mori këtë:

V E N D I M

I.<u>APROVOHET</u>, pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: "Albi Company"shpk- Rahovec, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Punët përfundimtare – Restaurimi Konservimi i Kullës Fazli Boqollit, Raushiç-Pejë", me numër të prokurimit: 207-20-2516-5-2-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve"/MKRS/.

<u>II.ANULOHET</u>, njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Punët përfundimtare – Restaurimi Konservimi i Kullës Fazli Boqollit, Raushiç-Pejë", me numër të prokurimit: 207-20-2516-5-2-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve"/MKRS/, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV .Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "Albi Company"shpk- Rahovec, aprovohet pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI . Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues OE "Albi Company"shpk- Rahovec, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 30.10.2020 me nr. 870/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Punët përfundimtare – Restaurimi Konservimi i Kullës Fazli Boqollit, Raushiç-Pejë", me numër të prokurimit: 207-20-2516-5-2-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve"/MKRS/, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 6, 7, 59, 60, dhe 68 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nenin 41.8 i RRUOPP-së,
- Njoftim vendimi i AK me datën 12/08/2020
- Vendimi mbi aprovimin te Ri-kërkesës për rishqyrtim 1NR prot 2953/20 DT 02/09.2020

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 02.11.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 12.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në pretendimin nr.1

Pretendimi i parë dhe kryesor ankimorë i OE ankues sipas ankesës nr.870/20 ka të bëjë me arsyen e eliminimit të OE ankues nga ana e AK-së, ku në njoftim për eliminim AK ka konstatuar se OE ankues është i papërgjegjshëm sespse CV-të e ofruara janë të nënshkruara nga punëdhënësi dhe të vulosura nga kompania. Ndërsa sipas AK-së citomjë *"CV-ja është personale dhe duhet të nënshkruhet personalisht nga personi për të cilin është CV-ja"*…

Vlerësojmë se arsyetimi i AK-së për eliminim nuk është i bazuar në kërkesa të dosjes së tenderit, sepse

askund në dosje nuk ceket se nga kush duhet të jetë e nënshkruar CV-ja.

Po ashtu neni i UOPP-së që i refereohet AK ku thuhet "CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat-Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të ", konsiderojmë se është i pabazuar sepse nuk ka qenë **kërkesë** e dosjes që CV të nënshkruhet nga personi për të cilin është CV-ja.

Po ashtu sipas AK-së në njfotim për eliminim AK-së kosntaton se sa i përket inxhinierit të elektroteknikës **Urim Tasholli**, referenca është e lëshuar nga **Albi Company** për z.Tasholli, mirëpo se në përshkrimin e deklaratës së OE është cekur emri i personit tjetër Vehbi Muharremi.

Lidhur me këtë pretendim ankimorë OE në ankesë sqaron se referenca është lëshuar për z.Tasholli, (gjë që nuk e mohon as AK-MKRS), dhe se emri Vehbi Muharremi ka mbetur si gabim teknik gjatë përpilimit të referencës.

Duke pas parasyshë se lëshues i referencës është vet OE:"Albi Company" dhe se i njëjti ka dhënë sqarim se bëhet fjalë për lëshim teknik, vlerësojmë se pretnedimi ankimorë është i bazuar dhe se një

Përgjigje në pretendimin nr.2

Sa i përket pretendimeve ankimorë për OE tjerë, të njëjtit janë vlerësuar të papërgjegjshëm nga ana e AK-MKRS andaj vlerësojmë se pretendimet ankimore janë të bazuara.

Përgjigje në pretendimin nr.3

Lidhur me pretendimin ankimore kundrejt OE"Pleqa" të rekomanduar për kontratë, Oe ankues pretendon se ky OE për projekt menaxher ka caktuar Ardita Berisha e cila nuk është në listë të stafit të OE, e po ashtu nuk është listë të punëtorëve në ATK të OE.

Pas analizimit të ofertës të OE Pleqja, kemi hasur se OE ka kontratë me afat të caktuar me znj.Berisha pikërisht për këtë aktivitet të prokurimit. Po ashtu ak të bashkangjitur dëshmitë tjera të këruara në dosje si diploma, referenca etj. Po ashtu vlerësojmë se lista e punëtorëve në ATK nuk ka qenë kërkesë e dosjes së tenderit.

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se mungesa e emrit të znj.Berisha në listë të stafit është devijim i vogël nga kërkesat e dosjes i cili nuk përbën ndonjë ndryshim material të ofertës së OE, andaj vlerësojmë se pretendimi ankimorë dhe kërkesa për eliminim të OE të rekomanduar për kontratë me këtë arsyetim është e pabazuar.

Vlenë të ceket se OE ankues është me cmim më të ulët se OE i rekomanduar për kontratë.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht e bazuar, ndërsa të anulohet vendimi i AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në **Rivlerësim.**

Autoriteti Kontraktues nuk ka përgjigje.

Operatori Ekonomik, me datë: 13.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se PAJTOHET me mendimin e ekspertit shqyrtues , ku sqaron ne si OE pajtohemi me mendimin e ekspertit shqyrtues rreth konstatimit nr 1 qe ka konfirmuar se ne si OE konkurruese Albi Company jemi përgjegjëse dhe me çmim me te lire.

Ndërsa nuk pajtohemi me konstatimin nr 2 ndaj OE Pleqa. Arsyeja e mos pajtimit është sepse ne përshkrimin e pretendimit ankimor nuk e ka shpjeguar te gjithë e piken ankimore.

Ne si OE ne piken ankimore ndaj OE Pleqa kemi sqaruar :Per personin i caktuar per projekt menaxher z. Berisha ka referenca te lëshuar nga OE Pleqa qe sqaron se Z. Berisha ka punuar ne periudhën 2016, 2017, 2018, por sipas listën se ATK-së te viteve 2020, 2019, 2018, 2018 sqarohet se nuk ka qen e punësuar.

Po ashtu sipas CV-së te z. Berisha e cila është e caktuar projekt menaxhere sqarohet se si punëtoret ne kompaninë Pleqa është e angazhuar qe nga viti 2007 dhe vazhdon.

E vërtete është qe nuk është kërkuar Lista e punëtoreve nga ATK, por listat e ATK-së te viteve 2017, 2018, 2019, 2020 janë dokumente dëshmuese ku konfirmojn se referenca e lëshuar nga OE Pleqa për z. Berisha nuk përputhen me vertetsine me ATK.

Per keto pika ankimore eksperti shqyrtues nuk ka thëne konstatim ne ekspertizë.

Bazuar se lenda eshte aprovuar dhe kthehet ne rivlesim dhe eshte konstatuar nga eksperti se AK MKRS neve si OE na ka diskualifikuar pa baze ligjore ne si OE nuk kerkojm seance me panelin shqyrtues, por kerkojm nga paneli shqyrtues qe ta autorizoj AK MKRS qe ta respektoj nenin 60 LPP duke na shpërblyer me koftrat neve si OE konkurruese me çmim me te lire te cilën e ka konfirmuar edhe eksperti.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 23.11.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit

të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar ne OSHP kundër njoftimit per dhëni te kontratës.

Paneli shqyrtues sqaron se me date 06.11.2020 OE ankues i drejtohet OSHP-se me emailin si me poshtë:

From: OSHP <oshp@rks-gov.net>
Sent: 06/Nov/20 10:44
To: Blerim Dina <Blerim.Dina@rks-gov.net>
Subject: FW: KERKESE , INFORMIM ANKESA NR 870/20 KULLA RAUSHIQ

From: Albi Company [mailto:albi_company@yahoo.com]
Sent: Friday, November 6, 2020 10:32 AM
To: OSHP; Iber Alaj
Subject: KERKESE , INFORMIM ANKESA NR 870/20 KULLA RAUSHIQ

Përshendetje

Përmes kësaj shkrese ju informojmë ne si OE Albi Company shpk, Rahovec bazuar me paragrafi 1 dhe 2 neni 109 LPP kemi bërë **ANKESE** me nr prot **870/20** më datën **30/10/2020** ndaj A**K-së MKRS** Ministria Kultures Rinise dhe Sportit për procedurën tenderuese me titull: **PUNET PERFUNDIMTARE-RESTAURIMI KONSERVIMI I KULLËS FAZLI BOQOLLIT,RAUSHIÇ-PEJË dhe** Numri i Prokurimit: 207-20-2516-5-2-1.

AK-së MKRS duke mos respektuar paragrafin **1 nenit 112** nuk e **PEZULLON** procedurën tenderuese të lartëcekur pasiqë ka Ankesë në OSHP.

Ku ne si OE Ankues më datën **04/11/2020** përmes e-prokurimit kemi pranuar Njoftimin për dhënje kontratës dhe Njoftim -KONTRATËN e cila është nënshkruar më datën **03/11/2020** në mes **AK MKRS dhe OE.**

Vendimi për nënshkrimin e kontratës është **JO LIGJORE** dhe **SKANDALOZ** ku është në kundershtim me **nenin 113,114,115,166 LPP** pasiqe nuk është pranuar ende **eskpertiza** dhe as **Vendimi nga panelli shqyrtues i OSHP-së**

Presim nga Panelli shqyrtues i OSHP të ndërmirren masa.

Të bashkëgjitur dokumentat:

Ankesa nr 870/20

Kontrata, Informimi përmes e-prokurimit
Njoftimi për dhënje kontratës, informimi përmes e-prokurimit

Ju lutem konfirmoni marrjen email

Me respekt
Albi Company sh.p.k
Qazim Bytyqi arch.
Drejtor Gjeneral
Rr.Sylejman Vokshi p.n
21000 Rahovec-Kosove
Mob. +377 44 152 846
E-mail: albi_company@yahoo.com

Ndërsa Kryetari i OSHP-se po te njëjtën dite me 06.11.2020 i drejtohet OE ankues si me poshtë:

From: Blerim Dina
Sent: 06/Nov/20 21:17
To: 'albi_company@yahoo.com' <albi_company@yahoo.com>
Cc: OSHP <oshp@rks-gov.net>; Sebahate Boshnjaku <Sebahate.Boshnjaku@rks-gov.net>; Iber Alaj <Iber.Alaj@rks-gov.net>; Nuhi Paqarizi <Nuhi.Paqarizi@rks-gov.net>; Goran Milenkovic <Goran.Milenkovic@rks-gov.net>
Subject: FW: KERKESE , INFORMIM ANKESA NR 870/20 KULLA RAUSHIQ

Te nderuar,
OSHP me date 30.10.2020 ka pranuar ankesën me numër te protokollit 870/20, dhe ankesa po shqyrtohet ne mënyrë te rregullt nga OSHP.
AK-të i dijnë obligimet ligjore konform LPP-se nëse dorëzohet një ankese në OSHP.
Sikurse jeni njoftuar Ju si OE me rastin e dorëzimit te ankesës nga sistemi i E-prokurimit, në mënyrë te njëjtë është njoftuar edhe AK.
Konform afateve kohore dhe procedurave do te merret vendimi per lëndën.
Me shume respekt,
Blerim DINA, Kryetar
Organi Shqyrtues i Prokurimit
Rr.Migjeni (ish banka e Lublanes, Kati i V-te)
10 000 Prishtinë, tel: 038 212360,
blerim.dina@rks-gov.net, http://oshp.rks-gov.net/

OSHP nuk e ka asnjë informate zyrtare nga AK-Ministria e Kulturës qe ka lidhe kontrate apo jo me OE-ne e rekomanduar per kontrate dhe OSHP ka vazhduar me shqyrtimin e pretendimeve ankimore si me poshtë:

Lidhur me pretendimin që ka të bëjë me arsyen e eliminimit të OE ankues nga ana e AK-së, ku në njoftim për eliminim AK ka konstatuar se OE ankues është i papërgjegjshëm sespse CV-të e ofruara janë të nënshkruara nga punëdhënësi dhe të vulosura nga kompania. Ndërsa sipas AK-së citomjë *"CV-ja është*

personale dhe duhet të nënshkruhet personalisht nga personi për të cilin është CV-ja"…

Paneli shqyrtues konform sqarimeve te ekspertit shqyrtues konstaton se arsyetimi i AK-së për eliminim nuk është i bazuar në kërkesa të dosjes së tenderit, sepse askund në dosje nuk ceket se nga kush duhet të jetë e nënshkruar CV-ja.

Po ashtu neni i UOPP-së që i refereohet AK ku thuhet "CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat-Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të ", konsiderojmë se është i pabazuar sepse nuk ka qenë **kërkesë** e dosjes që CV të nënshkruhet nga personi për të cilin është CV-ja.

Po ashtu sipas AK-së në njoftim për eliminim AK-së konstaton se sa i përket inxhinierit të elektroteknikës **Urim Tasholli**, referenca është e lëshuar nga **Albi Company** për z.Tasholli, mirëpo se në përshkrimin e deklaratës së OE është cekur emri i personit tjetër Vehbi Muharremi.

Lidhur me këtë pretendim ankimorë OE në ankesë sqaron se referenca është lëshuar për z.Tasholli, (gjë që nuk e mohon as AK-MKRS), dhe se emri Vehbi Muharremi ka mbetur si gabim teknik gjatë përpilimit të referencës.

Duke pas parasyshë se lëshues i referencës është vet OE:"Albi Company" dhe se i njëjti ka dhënë sqarim se bëhet fjalë për lëshim teknik, vlerësojmë se pretnedimi ankimorë është i bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimorë për OE tjerë, të njëjtit janë vlerësuar të papërgjegjshëm nga ana e AK-MKRS andaj vlerësojmë se pretendimet ankimore janë të bazuara.

Lidhur me pretendimin ankimore kundrejt OE"Pleqa" të rekomanduar për kontratë, OE ankues pretendon se ky OE për projekt menaxher ka caktuar Ardita Berisha e cila nuk është në listë të stafit të OE, e po ashtu nuk është listë të punëtorëve në ATK të OE.

Paneli shqyrtues konform sqarimeve te ekspertit shqyrtues konstaton se pas analizimit të ofertës të OE Pleqja, kemi hasur se OE ka kontratë me afat të caktuar me znj. Berisha pikërisht për këtë aktivitet të prokurimit. Po ashtu AK të bashkangjitur dëshmitë tjera të kërkuara në dosje si diploma, referenca etj. Po ashtu lista e punëtorëve në ATK nuk ka qenë kërkesë e dosjes së tenderit.

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se mungesa e emrit të znj .Berisha në listë të stafit është devijim i vogël nga kërkesat e dosjes i cili nuk përbën ndonjë ndryshim material të ofertës së OE, andaj vlerësojmë se pretendimi ankimorë dhe kërkesa për eliminim të OE të rekomanduar për kontratë me këtë arsyetim është e pabazuar.

Vlen të ceket se OE ankues është me çmim më të ulët se OE i rekomanduar për kontratë.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.
Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Paneli Shqyrtues

Nahi PAÇARIZI

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK –" Ministria e Kulturës Rinis dhe Sportit /MKRS/

1x1 OE - ALBI COMPANY- Rahovec.

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.